



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2976/ 2 prot.,

Datë 01.12.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Trade and Construction Group*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. *REF-84498-10-20-2023*, me objekt: “*Blerje pajisje elektrike për pastrimin e hapësirave urbane*”, me fond limit 7.080.000 (*shtatë milion e tetëdhjetë mijë*) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Ankimues: Operatori ekonomik “*Trade and Construction Group*” SHPK me Nipt M11320022Q, me adresa: rruga “Marko Bocari”, pallati “TID”, Shkalla 1, Apartamenti 3, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.
Adresa: Rruga “Xhezmi Delli”, Godina nr.20, Tiranë.

Në datën 30.11.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 2976 prot, datë 30.11.2023 e operatorit ekonomik “*Trade and Construction Group*” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. *REF-84498-10-20-2023*, me objekt: “*Blerje pajisje elektrike për pastrimin e hapësirave urbane*”, me fond limit 7.080.000 (*shtatë milion e tetëdhjetë mijë*) lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 09.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “*Trade and Construction Group*” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimes “Trade and Construction Group” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 2976 prot., datë 30.11.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Ne kriteret Teknike ne DST pika 2.3.1 Kontrata te ngajshme Operatori ekonomik ka ngarkuar ne sistem kontrate me objekt :makina teknologjike per coptimin mbetjesh drusore e cila punon me karburant nderkohe kerkohet makine elektrike per thithe te fuqishme inertesh e cila nuk ka lidhje me objektin e kontrates se kerkuar.

Ne kriteret Teknike ne DST pika 2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me ertifikataten cilësie ISO 50001-2018 Kjo çertifikate nga Operatori ekonomik NUK eshte paraqitur.

Ne kriteret Teknike ne DST pika 2.3.3 Ne katalogun e ngarkuar ne system nga operatori konomik tek specifikimet teknike te mjetit te kerkuar nga AK Nuk e permbush specifikimet teknike si me poshte: 1. Pesha e kerkuar total e mjetit nga AK duhet te jete ne < 500 kg (per arsye se kjo makineri do te qarkulloje ne pedonalen e parkut dhe kerkohet kjo peshe qe mos demtohet edonalja nga qarkullimi i makines) ndersa OE kaq paraqirur peshen e pajisjes pa bateri dhe jo peshen totale te makines ne total .

2. Nuk ka specifikime per baterin e mjetit . Nga AK eshte kerkuar Bateritë xhel me acid plumbi.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 01.12.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri